

- **PAISJA ME LEJEDREJTIMI PËR HERË TE PARË DHE SHITESË KATEGORIE**

Regjistrimi i aplikantit në Drejtori Rajonale bëhet nëpërmjet autoshkollës që e përgatit kandidatin për paisje me lejedrejtimi.

A. Lejedrejtimi për herë të parë (kur aplikanti nuk disponon asnjë kategori lejedrejtimi)

a- Për shtetasit shqiptarë

1. Kërkesë me shkrim pranë Autoshkollës ku kërkon të rregjistrohet;
2. Dokument identifikimi;
3. Vërtetimin e banimit të lëshuar nga organet e pushtetit vendor;
4. Certifikatë mjekësore me fotografi, të lëshuar me datë jo më përpara se 3 (tre) muaj nga data e paisjes me autorizim;
5. Dokumentin e përcaktimit të Grupit të Gjakut dhe Rehzusin;
6. 2 (dy) copë fotografi me ngjyra, me përmasa 4 x 5 cm, njëra nga të cilat nga pas të jetë e nënshkruar nga aplikanti (emër, mbiemër);

b- Për shtetasit e huaj rezidentë në Shqipëri

1. Kërkesë me shkrim pranë Autoshkollës ku kërkon të rregjistrohet;
2. Dokument identifikimi (fotokopje të pasaportës të përkthyer në gjuhën shqipe, të legalizuar nga noteri);
3. Fotokopje të lejes së qëndrimit të lëshuar nga organet e policisë së shtetit, të legalizuar nga noteri, me afat skadence, jo më përpara se afati i vlefshmërisë së autorizimit që kërkohet;
4. Certifikatë mjekësore me fotografi, të lëshuar me datë jo më përpara se 3 (tre) muaj, nga data e paisjes me autorizim;
5. Dokumentin e përcaktimit të Grupit të Gjakut dhe Rehzusin;
6. 2 (dy) copë fotografi me ngjyra, me përmasa 4 x 5 cm, njëra nga të cilat nga pas të jetë e nënshkruar nga aplikanti (emër, mbiemër);

c- Për personelin e huaj të Ambasadave ose të Organizatave Ndërkombëtare, që gëzojnë statusin diplomatik, të instaluar në Shqipëri

1. Kërkesë me shkrim pranë Autoshkollës ku kërkon të rregjistrohet;
2. Fotokopje të kartës së legjitimitetit të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe fotokopje të pasaportës të legalizuar nga ambasada;
3. Certifikatë mjekësore me fotografi, të lëshuar me datë jo më përpara se 3(tre) muaj, nga data e paisjes me autorizim;
4. Dokumentin e përcaktimit të Grupit të Gjakut dhe Rehzusin;
5. 2 (dy) copë fotografi me ngjyra, me përmasa 4 x 5 cm, njëra nga të cilat nga pas të jetë e nënshkruar nga aplikanti (emër, mbiemër);

B. Leje drejtimi për shtesë kategorie

1. Kërkesë me shkrim pranë Autoshkollës ku do të rregjistrohet;
2. Dokument identifikimi;
3. Vërtetim banimi të lëshuar nga organet e pushtetit vendor (vërtetim për ata që u ndryshon adresa ose nuk kanë lejedrejtimi pararendëse dixhitale);
4. Certifikatë mjekësore me fotografi, të lëshuar me datë jo më përpara se 3 (tre) muaj, nga data e paisjes me autorizim;
5. Dokumentin e përcaktimit të Gjakut dhe Rehzusin (vetëm për ata që nuk kanë lejedrejtimi ekzistuese dixhitale);

6. Lejen e drejtimit ekzistuese origjinale dhe fotokopje (origjinali kthehet dhe dorezohet në momentin e shpalljes fitues në praktikë);

7. 2(dy) copë fotografi me ngjyra, me përmasa 4 x 5 cm, njëra nga të cilat nga pas të jetë e nënshkruar nga aplikanti (emër, mbiemër);

Autorizimi teorik dhe praktik është i vlefshëm një vit nga data e lëshimit.